

VENDIM
Nr. 25, datë 5.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 5.3.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 15 (B) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., përfaqësuar nga Ndue Maluta, përfaqësues ligjor.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “INSIG” sh.a., përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Kadri Morinaj.

Avokatura e Shtetit, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4553, datë 6.11.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, pika 1, 16, pika 2, 17, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, shoqërisë “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a. (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë “INSIG” sh.a. (*shoqëria e sigurimit*), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjektit tjetër të interesuar, Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është një shoqëri tregtare që ushtron veprimtari bankare, për të cilën ka lidhur me shoqërinë e sigurimeve “INSIG” sh.a. një kontratë sigurimi sipas policës së sigurimit me mbulim të plotë, me nr. 08/2010, datë 27.1.2010, e vlefshme për një vit. Në këtë kontratë, “Pabesueshmëria e punonjësve” ishte parashikuar si rast sigurimi dhe mbulohej në vlerën 1.000.000 dollarë amerikanë (*USD*) për çdo dëm dhe në agregat.

2. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së policës së sigurimit, kërkuesja ka konstatuar përvetësimin e shumave të konsiderueshme nga llogaritë dhe depozitat e klientëve nga një punonjës i saj. Në lidhje me këtë, të vëna në lëvizje nga kërkuesja, janë zhvilluar paralelisht një proces penal dhe dy procese civile, njëri ndaj shoqërisë së sigurimeve dhe tjetri ndaj autorëve të veprës penale.

Procesi penal

3. Në datën 10.12.2010, kërkuesja ka depozituar një kallëzim penal për veprimet mashtruese të kryera nga një punonjës i saj në llogaritë bankare dhe depozitat e klientëve në degën e Vlorës.

Në çështjen penale të filluar në bazë të këtij kallëzimi, ish-punonjësi i kërkueses G.H. dhe shtetasi F.H., i lidhur me të, me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit Vlorë nr. 269, datë 12.7.2013, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 229, datë 10.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dhe që është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2016-1221(154), datë 13.7.2016, janë deklaruar fajtorë për kryerjen e veprave penale “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”, të parashikuara nga nenet 135, 287/2, 186/2 dhe 293/6 të Kodit Penal.

Procesi civil ndaj autorëve të veprës penale

4. Pas përfundimit të procesit penal në gjykatën e apelit, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi duke kërkuar nga autorët e veprës penale, si dhe nga disa subjekte të tjera të lidhura me ta, shpërblimin e dëmit pasuror të pësuar, fitimin e munguar mbi shumat e dëmit të shkaktuar nga vepra penale, të gjitha të ardhurat dhe përfitimet e realizuara nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të kundërligjshme, në formën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe investimeve në to. Në këtë proces shoqëria e sigurimit ka qenë në cilësinë e personit të tretë.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 598, datë 14.4.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë dhe detyrimin e të paditurve G. H., F. H. dhe shoqërisë tregtare “A.” për t’i dëmshpërblyer kërkueses në mënyrë solidare: i. dëmin pasuror të drejtpërdrejtë të pësuar nga kërkuesja në vlerat 73.000.044,84 lekë, 1.860.058,26 euro, 131.992,25 USD dhe 16.000 paund; ii. dëmin pasuror në formën e fitimit të munguar të pësuar në shumën 85.907.278,2 lekë; iii. dëmin jopasuror për të gjitha format e individualizuara në atë vendim në shumën 1.000.000 lekë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 976, datë 27.9.2016. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, kjo çështje është regjistruar në këtë gjykatë me numër 11118-01578-00-2017, në datën 8.5.2017, mbi rekursin e të paditurve F. H. dhe shoqërisë “A.”, ndërsa shqyrtimi i saj është ende në proces.

Procesi civil ndaj shoqërisë së sigurimeve

6. Në datën 24.12.2010, pas kallëzimit penal ndaj punonjësit të saj, kërkuesja ka njoftuar edhe shoqërinë e sigurimit, subjektin e interesuar “INSIG” sh.a., se divizioni i saj i kontrollit të brendshëm kishte filluar një kontroll administrativ specifik në degën e Vlorës lidhur me disa veprime përvetësimi të shumave në vlera të mëdha në disa llogari dhe depozita bankare nga një punonjës i bankës, me dëm të përllogaritur mbi 1.000.000 euro. Pas njoftimit të ngjarjes së pretenduar si rast siguri, shoqëria e sigurimit i ka kërkuar kërkueses informacione dhe dokumentacion mbështetës. Kërkuesja i ka vënë asaj në dispozicion një relacion shpjegues dhe një sërë aktesh, si raportin përfundimtar të kontrollit të brendshëm, shkresën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për procedimin penal të shkaktarëve të dëmit dhe disa të dhëna për personat e marrë nën përgjegjësi penale, veprat penale për të cilat ata akuzoheshin dhe masat e sigurimit personal të vendosura nga gjykata. Më pas, mbi kërkesën e shoqërisë së sigurimit, kërkuesja i ka ofruar asaj edhe disa shpjegime e dokumente të mëtejshme.

7. Në datën 21.5.2012, duke qenë se shoqëria e sigurimit nuk i njohu dhe nuk i akordoi dëmshpërblimin sipas policës së sigurimit nr. 08/2010, datë 27.1.2010, kërkuesja i është drejtuar gjykatës duke kërkuar detyrimin e shoqërisë së sigurimit për t’i shpërblyer dëmin në vlerën 1.000.000 USD dhe interesin mbi këtë shumë të papaguar për periudhën nga data e njoftimit deri në datën e shlyerjes së detyrimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7, datë 6.1.2015, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e shoqërisë së sigurimit: i. për të dëmshpërblyer kërkuesen në shumën 1.000.000 USD, si detyrim që buron nga polica e sigurimit nr. 08/2010, datë 27.1.2010; ii. për të paguar interesin mbi shumën e papaguar në formën e fitimit të munguar, në shumën 73.094 USD; iii. për të paguar interesin në masën 55,54 USD në ditë deri në ditën e përmbushjes së detyrimit nga pala e paditur. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2602, datë 15.12.2016, mbi ankimin e shoqërisë së sigurimit, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e kërkueses. Për rekursin e kësaj të fundit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4553, datë 6.11.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me

arsyetimin se rekursi nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

8. Në datën 17.4.2025, nëpërmjet shërbimit postar, kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë të dhënë në procesin civil ndaj shoqërisë së sigurimeve. Kolegji i Gjykatës në datën 1.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkesja,** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1 *Së drejtës së aksesit në gjykatë në aspekt të së drejtës së ankimit substancial,* pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje të shprehur pretendimit të ngritur në rekursin e saj se gjykata e apelit ka vepruar në shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, në rrethanat kur vendimmarrjen e saj e ka mbështetur edhe në një provë dhe argument që nuk ishte bërë objekt i debatit gjyqësor ndërmjet palëve, siç është evidentuar edhe në mendimin e gjyqtarës në pakicë në apel. Ky pretendim është ngritur nga kërkesja në parashtrimet shtesë në mbështetje të rekursit dhe është pasqyruar edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë, por pa marrë përgjigje të arsyetuar nga ajo.

9.2 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit,* pasi gjykata e apelit e ka bazuar vendimmarrjen e saj edhe në një argument dhe në një provë që nuk ishte paraqitur dhe nuk ishin bërë objekt i debatit gjyqësor ndërmjet palëve, konkretisht që kërkesja ishte shpërblyer tashmë për dëmin e pësuar nga vetë shkaktarët e dëmit nëpërmjet padisë civile për shpërblimin e dëmit jokontraktor. Ky pretendim është parashtruar nga shoqëria e sigurimit vetëm në parashtrimet përfundimtare përpara gjykatës së apelit, ndaj ai nuk i është nënshtruar debatit gjyqësor dhe, rrjedhimisht, kërkesja është vënë në pozita të pabarabarta krahasuar me palën tjetër, pasi asaj nuk i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur lidhur me sa ka konkluduar gjykata e apelit. Kjo e fundit, po ashtu, nuk e ka dorëzuar në kohë vendimin e arsyetuar, ndaj pretendimi është ngritur prej kërkeses në parashtrimet shtesë të bëra në funksion të rekursit. Në këtë mënyrë është cenuar edhe *parimi i disponibilitetit dhe i paanësisë së gjykatës.*

9.3 *Parimit të sigurisë juridike,* pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë cenuar të drejtat që i ka fituar nga kontrata e sigurimit, duke dështuar të bëjnë dallimin midis marrëdhënies juridike nga e cila ka lindur mosmarrëveshja në këtë proces gjyqësor dhe asaj në procesin tjetër ndaj shkaktarëve të dëmit. Nëse pranohet ekzistenca e një marrëdhënieje juridike kontraktore, sikundër është kontrata e sigurimit, e cila nuk është zgjidhur ose ndryshuar nga palët, atëherë përfundimi i gjykatave se shoqëria e sigurimit është çliruar nga detyrimi për të përmbushur kontratën cenon sigurinë juridike të kërkeses në lidhje me të drejtat e fituara nga ajo nëpërmjet kësaj kontrate. Për më tepër, ndryshe nga sa gjykatat arsyetojnë, kërkesja nuk e ka realizuar të drejtën e dëmshpërblimit ndaj shkaktarëve të dëmit, pasi detyrimi kontraktor monetar i shoqërisë së sigurimit ka një kufi të caktuar, konkretisht 1.000.000 USD, çka do të thotë se ajo nuk ka detyrimin të mbulojë vlera dëmi tej këtij kufiri, të cilat kërkesja ka kërkuar t'i realizojë ndaj shkaktarëve të dëmit. Padia ndaj këtyre të fundit ka shkak ligjor të ndryshëm nga ajo për përmbushjen e detyrimit kontraktor ndaj shoqërisë së sigurimit dhe ato nuk zëvendësojnë njëra-tjetrën, prandaj kërkesja nuk ka përfituar dy herë vlerën e dëmit, sikurse gjykatat arsyetojnë në vendimet e tyre. Për më tepër, debitori ka mjete procedurale për të kundërshtuar ekzekutimin e një detyrimi më shumë se një herë.

10. **Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimit "INSIG" sh.a.,** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se kërkesa është e pabazuar, pasi:

10.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e ankimit substancial* nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve në rekursin e kërkeses në përputhje me natyrën e shqyrtimit në dhomën e këshillimit, duke vlerësuar se

ai nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së dhe duke theksuar se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngrinte çështje të vlerësimit të provave dilte jashtë juridiksionit rishikues të saj. Në vendimin e asaj gjykate janë pasqyruar shkaqet e rekursit dhe përfundimi i arritur. Kjo formë arsyetimi e vendimit është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij në dhomën e këshillimit. Ajo gjykatë nuk ka bërë një vlerësim formal të rekursit, pasi është shprehur në të njëjtën linjë me gjykatën e apelit në lidhje me realizimin nga kërkuesja të së drejtës së dëmshpërblimit drejtpërdrejt nga përgjegjësit e dëmit. Po kështu, kërkuesja nuk tregon konkretisht se cilat janë pretendimet me natyrë kushtetuese, të cilave Gjykata e Lartë duhet t'u kishte dhënë përgjigje domosdoshmërisht.

10.2 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* nuk qëndron, pasi gjykimi në gjykatën e apelit është vënë në lëvizje me ankimin e shoqërisë së sigurimit dhe kërkuesja nuk ka paraqitur kundërankim, ndërkohë që palët kanë marrë pjesë në gjykim dhe kërkuesja, në veçanti, ka pasur mundësi të paraqesë pretendimet dhe argumentet ligjore të saj mbi provat dhe faktet. Shoqëria e sigurimit nuk ka ngritur pretendime të reja dhe të gjitha pretendimet kanë qenë pjesë e debatit gjyqësor edhe në gjykatën e shkallës së parë. Ajo që paraqitet nga kërkuesja si shkelje procedurale në fakt lidhet me themelin e mosmarrëveshjes, përfshirë kushtet e mbulimit të policës, ekzistencën e dëmit, kushtet paraprake të përgjegjësisë së siguresit dhe pasojat e shpërblimit të kërkuar ose të realizuar ndaj shkaktarëve të dëmit. Gjykata e Lartë e ka njoftuar kërkuesen për datën dhe orën e gjykimit, duke i dhënë të drejtën asaj për të paraqitur kundërshtimet e veta, ndërkohë që çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 482/a të KPC-së dhe në përputhje me kompetencën lëndore të asaj gjykate. Jo në të gjitha rastet kur dy gjykatat e faktit kanë bërë një interpretim të ndryshëm të ligjit, Gjykata e Lartë ka detyrimin të shprehet lidhur me mënyrën sesi ligji i zbatueshëm duhet interpretuar, megjithatë në rastin konkret ajo është shprehur se gjykata e apelit e ka zbatuar drejt ligjin.

10.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, pasi kërkuesja e ka kërkuar dhe e ka realizuar të drejtën e dëmshpërblimit drejtpërdrejt nga shkaktarët e dëmit. Siç ka arsyetuar edhe gjykata e apelit, përmes vendimit të formës së prerë, kërkuesja ka në dorën e saj një instrument të ekzekutueshëm, ndaj nuk mund të pretendojë një dëmshpërblim të dytë ndaj shoqërisë së sigurimit, ndërsa një zgjidhje e kundërt do ta vinte këtë të fundit në pamundësi për të ushtruar padinë e regresit. Po ashtu, shoqëria e sigurimit nuk e ka refuzuar procedurën administrative për kërkimin e mbulimit të ngjarjes së pretenduar të sigurimit, por ka qenë vetë kërkuesja që i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar dëmshpërblimin drejtpërdrejt nga shkaktarët e dëmit. Për më tepër, këto pretendime nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

11. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit***, ndonëse është njoftuar rregullisht, nuk ka paraqitur shpjegime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejt e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Gjykata fillimisht vëren se kërkuesja, në objektin e ankimit kushtetues individual, ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës

së Lartë, ndërsa në përmbajtjen e tij ka kundërshtuar edhe vendimin e gjykatës së apelit të marrë në atë proces gjyqësor ku ajo ka qenë palë ndërgjyqëse. Nisur nga kjo, Gjykata çmon se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f”, të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës “i”, të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, pasi kundërshton procesin gjyqësor në të cilin ka qenë palë dhe ka interes të drejtpërdrejt për çështjen e parashtruar.

14. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, ku i ka ngritur edhe në substancë pretendimet e saj kushtetuese. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Për sa i takon kriterit paraprak të legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës, të cilin, në rastin e vendimeve gjyqësore, Gjykata e ka lidhur me momentin e vënies në dijeni të vendimit të arsyetuar. Në rastin konkret procesi gjyqësor ka përfunduar me vendimin e datës 6.11.2024 të Gjykatës së Lartë, i cili i është komunikuar kërkeses nëpërmjet postës elektronike në datën 30.1.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 17.4.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe parimit të sigurisë juridike.

17. Lidhur me pretendimin për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, kërkesja ka argumentuar, në thelb, se gjykatat e zakonshme kanë cenuar të drejtat që i burojnë nga kontrata e sigurimit, duke mos dalluar marrëdhënien juridike objekt të këtij gjykimi nga ajo e procesit civil të zhvilluar ndaj shkaktarëve të dëmit dhe duke arritur, sipas saj, në përfundimin e gabuar se ajo e ka realizuar tashmë të drejtën e dëmshpërblimit. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimit “INSIG” sh.a., ka prapësuar, në thelb, se ky pretendim është i pabazuar, pasi kërkesja e ka kërkuar dhe e ka realizuar tashmë të drejtën e dëmshpërblimit drejtpërdrejt nga shkaktarët e dëmit, ndaj nuk mund të pretendojë sërish shpërblim nga shoqëria e sigurimit.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, i cili nënkupton, mes të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 50, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara, si element i këtij parimi, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Gjykata ka pohuar se siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimet nr. 10, datë 13.2.2017; nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar kur zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve në mënyrë përfundimtare (*shih vendimin nr. 12, datë 17.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Referuar argumenteve të kërkeses për këtë pretendim, Gjykata vlerëson se ajo nuk ndodhet në kushtet e ndonjë të drejte të fituar nga ligji ose me vendim gjyqësor të formës së prerë, e cila të jetë vënë në dyshim nga vendimet e kundërshtuara. Pretendimet e kërkeses në këtë drejtim kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe përbëjnë, në thelb, mosdakordësinë e saj për mënyrën sesi ato kanë interpretuar faktet dhe ligjin në funksion të zgjidhjes në themel të çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkeses, në thelb, ka të bëjë me të drejtën për proces të rregullt ligjor, ndaj do të analizohet në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, në këndvështrim të arbitraritetit ose paarsyeshmërisë së tij.

20. Për sa i takon pretendimit të kërkeses për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë në lidhje me të drejtën e ankimit substancial, Gjykata vëren se ai ka të bëjë me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, ndaj çmon ta analizojë në vijim të lidhur edhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Edhe pretendimi tjetër i kërkeses për cenimin e *parimit të*

barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe do të shqyrtohet në vijim për bazueshmërinë e tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë në lidhje me të drejtën e ankimit substancial dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

21. Kërkuesja ka pretenduar, në thelb, se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje të shprehur pretendimit në rekursin e saj se gjykata e apelit ka vepruar në shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, në rrethanat kur vendimmarrjen e saj e ka mbështetur edhe në një provë dhe argument që nuk ishte bërë objekt i debatit gjyqësor ndërmjet palëve, siç është evidentuar edhe nga gjyqtarja në pakicë në apel. Sipas kërkueses, ky pretendim është ngritur në parashtrimet shtesë në mbështetje të rekursit dhe është pasqyruar edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë, por pa marrë përgjigje të arsyetuar nga ajo. Gjithashtu, sipas kërkueses, gjykatat e zakonshme nuk kanë dalluar marrëdhënien juridike objekt të këtij gjykimi nga ajo e procesit civil të zhvilluar ndaj shkaktarëve të dëmit, duke arritur në përfundimin e gabuar se ajo e ka realizuar tashmë të drejtën e dëmshpërblimit. Po sipas saj, ekzistenca e kontratës së sigurimit, e pazgjidhur dhe e pandryshuar nga palët, përjashton përfundimin se shoqëria e sigurimit është çliruar nga detyrimi, ndërsa padia ndaj shkaktarëve të dëmit, që ka shkak ligjor të ndryshëm, nuk zëvendëson atë për përmbushjen e detyrimit kontraktor ndaj shoqërisë së sigurimit, aq më tepër kur detyrimi kontraktor monetar i siguruesit ka kufi të caktuar, konkretisht 1.000.000 USD, ndaj vlerat përtej këtij kufiri ajo ka kërkuar t'i realizojë ndaj shkaktarëve të dëmit. Për më tepër, sipas kërkueses, nuk mund të thuhet se ajo ka përfituar dy herë të njëjtin dëm, për sa kohë debitori ka mjete procedurale për të kundërshtuar ekzekutimin e një detyrimi më shumë se një herë.

22. Subjekti i interesuar, shoqëria e sigurimit “INSIG” sh.a., ka prapësuar se ky pretendim nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve në rekursin e kërkueses në përputhje me natyrën e shqyrtimit në dhomën e këshillimit, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së dhe duke theksuar se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngrinte çështje të vlerësimit të provave dilte jashtë juridiksionit rishikues të saj. Sipas subjektit të interesuar, në vendimin e Gjykatës së Lartë janë pasqyruar shkaqet e rekursit dhe përfundimi i arritur, ndërsa kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e kësaj gjykate, përderisa shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij në dhomën e këshillimit. Po sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka bërë një vlerësim formal të rekursit, pasi është shprehur në të njëjtën linjë me gjykatën e apelit në lidhje me realizimin nga kërkuesja të së drejtës së dëmshpërblimit drejtpërdrejt nga përgjegjësit e dëmit. Nga ana tjetër, shprehet subjekti i interesuar, kërkuesja nuk ka individualizuar në mënyrë konkrete pretendimet me natyrë kushtetuese, të cilave Gjykata e Lartë do të duhej t'u jepte përgjigje domosdoshmërisht. Gjithashtu, sipas tij, kërkuesja e ka kërkuar dhe e ka realizuar dëmshpërblimin drejtpërdrejt nga shkaktarët e dëmit, ndaj nuk mund të pretendojë sërish shpërblim prej shoqërisë së sigurimit, ndërsa ajo nuk e ka refuzuar procedurën administrative për kërkimin e mbulimit të ngjarjes së pretenduar të sigurimit, por ka qenë vetë kërkuesja që i është drejtuar gjykatës kundër shkaktarëve të dëmit. Për më tepër, sipas subjektit të interesuar, këto pretendime nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit në gjykatë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e së drejtës së aksesit në gjykim dhe së drejtës së ankimit efektiv. Në rastet kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsytimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas saj, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt

ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme **dhe, në mënyrë të veçantë**, i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se Gjykata e Lartë, **në kuadër** të parimit të *subsidiaritetit* që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura në rekurs dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimin nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Nën dritën e këtyre standardeve, Gjykata do të verifikojë nëse, **në rrethanat e rastit konkret**, Gjykata e Lartë, në respektim të parimit të subsidiaritetit, i ka kthyer përgjigje pretendimit me natyrë kushtetuese të kërkueses për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nga gjykata e apelit, duke analizuar arsyetimin e vendimit të saj, si në drejtim të përgjigjes ndaj këtij pretendimi, ashtu edhe në drejtim të qartësisë, plotësisë dhe mosarbitraritetit të argumenteve të përdorura prej saj.

25. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkuësja ka vënë në lëvizje procesin civil për njohjen e së drejtës së dëmshpërblimit ndaj shoqërisë së sigurimit, sipas policës përkatëse të sigurimit. Gjykata e shkallës së parë e ka pranuar padinë e saj, ndërsa gjykata e apelit, mbi ankimin e shoqërisë së sigurimit, ka ndryshuar vendimin dhe e ka rrëzuar padinë e kërkueses, duke e mbështetur këtë në tri argumente kryesore. *Së pari*, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se kërkuësja ishte dëmshpërblyer tashmë për dëmin e pësuar nga vetë shkaktarët e dëmit, ndaj nuk mund të përfitonte sërish ndaj siguruesit, duke iu referuar për këtë vendimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit në procesin civil të zhvilluar kundër autorëve të veprës penale (*shih paragrafët 4–5 të vendimit*). Sipas asaj gjykate, me nënshkrimin e policës së sigurimit, kërkuësja e ka transferuar riskun te shoqëria e sigurimit, dhe është kjo e fundit që, me padi regresi, duhet të kërkojë dëmshpërblimin nga shkaktarët e dëmit. Pavarësisht kësaj, kërkuësja ka zgjedhur t'i drejtohej me kërkesëpadi drejtpërdrejt palës që efektivisht ka shkaktuar dëmin dhe, sipas asaj gjykate, me vendim gjyqësor të formës së prerë ka fituar të drejtën e dëmshpërblimit nga ata. Në këtë kuptim, kërkuësja ka në dorë një titull ekzekutiv, ndaj ajo nuk mund të pretendojë të njëjtin dëmshpërblim ndaj shoqërisë së sigurimit. *Së dyti*, gjykata e apelit ka vlerësuar se polica e sigurimit është e pavlefshme, pasi veprimet e kundërligjshme të punonjësit të kërkueses kishin filluar para datës 27.1.2010, kur ishte lidhur kontrata e sigurimit midis palëve. *Së treti*, ajo ka çmuar se kërkuësja nuk ka përmbushur kushtet paraprake për përgjegjësinë e siguruesit, veçanërisht në drejtim të kontrollit të brendshëm, ndarjes së funksioneve dhe respektimit të lejes së pandërprerë dyjavore të punonjësve. Kërkuësja, jo vetëm që ka shkelur detyrimet e marra përsipër në kontratën e sigurimit, por me veprimet dhe neglizhencën e saj ndaj rregullave të brendshme për sigurinë ka shtuar në mënyrë të dukshme dhe me faj dëmin e shkaktuar.

26. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kërkuësja, fillimisht, ka paraqitur rekurs për zënie afati, duke pretenduar se nuk i ishte vënë në dispozicion vendimi i arsyetuar i asaj gjykate brenda afatit ligjor, çka, sipas saj, e kishte vënë në vështirësi për ushtrimin efektiv të ankimit, si dhe duke rezervuar të drejtën për paraqitjen e argumenteve shtesë pas njohjes me arsyetimin e plotë të vendimit. Më pas, në parashtimet e saj përpara Gjykatës së Lartë, ajo ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit si për zbatim të gabuar të ligjit material, ashtu dhe për shkelje të ligjit procedural. Në veçanti, kërkuësja ka pretenduar se gjykata e apelit e ka marrë vendimin në tejkalim të pretendimeve të paraqitura në ankimin e shoqërisë së sigurimit. Po sipas saj, gjykata e apelit e ka mbështetur vendimmarrjen e saj edhe në një provë dhe në një argument që, sipas saj, nuk kishin qenë objekt i debatit të rregullt gjyqësor ndërmjet palëve. Sipas kërkueses, gjykata e apelit ishte mbështetur, ndër të tjera, në vendimin nr. 976, datë 27.9.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë, të dhënë në procesin civil kundër autorëve të veprës penale, ndonëse kjo provë nuk ishte administruar në mënyrë të rregullt gjatë procesit gjyqësor dhe pretendimi përkatës i shoqërisë së sigurimit ishte ngritur vetëm gjatë parashtimeve përfundimtare. Për rrjedhojë, sipas kërkueses, asaj nuk i ishte dhënë mundësia të shprehej dhe të kundërshtonte këtë pretendim të shoqërisë së sigurimit, ndaj, për këtë arsye, gjykata e apelit ka shkelur parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

27. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se në rekursin e kërkuës nuk parashtroheshin shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, që mund të bënin të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit ka respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, dhe vendimi i saj nuk rezultonte të ishte në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Po sipas saj, nuk rezultonin shkelje procedurale që ta bënin të pavlefshëm procesin gjyqësor ose që ndikonin në vendimmarrjen e gjykatave, ndërsa pjesa e pretendimeve në rekurs që ngrinte çështje të vlerësimit të provave dilte jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj. Krahas këtyre vlerësimeve, Gjykata e Lartë ka theksuar posaçërisht se, pavarësisht ekzistencës së kontratës së sigurimit, kërkuësja, palë e dëmtuar nga ngjarja e sigurimit, e ka kërkuar shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga personat përgjegjës për shkaktimin e tij, kërkim i cili është pranuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Nisur nga kjo, sipas saj, në kushtet kur kërkuësja e ka realizuar të drejtën e shpërblimit të dëmit nëpërmjet një mjeti tjetër, ajo nuk mund të pretendojë përfitimin e dyfishtë nëpërmjet një padie të ngritur ndaj siguruesit, i cili, për më tepër, në këtë rast, do të vihej edhe në kushtet e pamundësisë së ngritjes së padisë së regresit ndaj shkaktarit të dëmit, në eventualitetin e pranimit të padisë për shpërblimin e dëmit të ngritur ndaj tij nga i siguruari.

28. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, veçanërisht i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme, pasi ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta ushtruar këtë rol aktiv, duke garantuar, në radhë të parë, respektimin e standardeve kushtetuese në procesin gjyqësor dhe duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta (*shih paragrafin 23 të vendimit*).

29. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuësja ka ngritur në rekurs një pretendim me natyrë kushtetuese, sipas të cilit gjykata e apelit e ka mbështetur vendimmarrjen edhe në një argument dhe në një provë që, sipas saj, nuk janë bërë objekt i debatit të rregullt gjyqësor ndërmjet palëve, duke cenuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Ndonëse Gjykata e Lartë e ka pasqyruar këtë pretendim në pjesën përshkruese të shkaqeve të rekursit, ajo nuk ka mbajtur një qëndrim të shprehur dhe konkret ndaj tij. Përkundrazi, në arsyetimin e vendimit të saj ajo ka theksuar posaçërisht, në të njëjtën linjë me gjykatën e apelit, se kërkuësja e kishte realizuar të drejtën e dëmshpërblimit drejtpërdrejt nga shkaktarët e dëmit, ndaj nuk mund të pretendonte përfitim të dyfishtë nëpërmjet një padie tjetër ndaj siguruesit, i cili, për më tepër, do të vihej në pamundësi për të ushtruar padinë e regresit. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë jo vetëm që nuk i ka dhënë përgjigje të shprehur pretendimit kushtetues të kërkuësës për mënyrën sesi kishte vepruar gjykata e apelit në aspektin procedural, por argumentin e përdorur prej saj si bazë për zgjidhjen në themel të çështjes e ka rimarrë, duke e konsideruar të drejtë, ndonëse kërkuësja e kishte kundërshtuar atë nga këndvështrimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Nisur nga natyra kushtetuese e këtij pretendimi dhe nga roli i Gjykatës së Lartë në kuadër të parimit të subsidiaritetit, Gjykata vlerëson se kjo e fundit duhet të kishte mbajtur një qëndrim të arsyetuar nëse pretendimi në fjalë i kërkuësës ishte ose jo i bazuar. Në këto kushte, mospranimi i rekursit të kërkuësës nga Gjykata e Lartë, pa i dhënë përgjigje të shprehur këtij pretendimi me natyrë kushtetuese, cenon të drejtën e saj për akses substancial në gjykatë dhe nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

30. Përpos kësaj, Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor edhe në drejtim të qartësisë dhe mosarbitraritetit të tij, në kuptim të gjykimit të drejtë. Në veçanti, ndonëse ajo ka pohuar se pretendimet e rekursit nuk përmbanin shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së dhe se çështjet që lidheshin me vlerësimin e provave dilnin jashtë juridiksionit rishikues të saj, nga ana tjetër ka rimarrë dhe ka konsideruar të drejtë një prej argumenteve themelore mbi të cilat gjykata e apelit kishte mbështetur zgjidhjen e mosmarrëveshjes, atë sipas të cilit kërkuësja e kishte realizuar tashmë të drejtën e dëmshpërblimit ndaj shkaktarëve të dëmit dhe, për këtë arsye, nuk mund të kërkonte sërish shpërblim nga siguruksi. Kjo mënyrë arsyetimi nuk lejon të kuptohet qartë nëse Gjykata e Lartë ka refuzuar shqyrtimin e rekursit për mungesë të

shkaqeve ligjore apo nëse, në të kundërt, ka hyrë në vlerësimin e themelit të një prej çështjeve qendrore të mosmarrëveshjes, duke miratuar zgjidhjen e gjykatës së apelit.

31. Po ashtu, edhe vetë argumenti i rimarrë nga Gjykata e Lartë nuk rezulton të jetë analizuar në mënyrë të plotë dhe të mjaftueshme. Së pari, ai mbështetet në vendimin nr. 976, datë 27.9.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë, pa u sqaruar se përse ky vendim, ndonëse i ekzekutueshëm sipas ligjit procedural, për sa kohë është rekursuar nga të paditurit në atë proces, mund të merret si bazë për përfundimin se kërkueses i është njohur përfundimisht e drejta e dëmshpërblimit, në kushtet kur ai nuk ka marrë ende cilësinë e gjësë së gjykuar (*res judicata*) dhe mbetet i cenueshëm nga Gjykata e Lartë në shqyrtim të rekursit. Së dyti, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar nëse ky vendim është ekzekutuar realisht dhe nëse kërkuessa e ka marrë efektivisht dëmshpërblimin, duke barazuar, në thelb, ekzistencën e një titulli ekzekutiv me realizimin konkret të së drejtës. Së treti, nuk rezulton të jetë bërë ndonjë analizë nëse ai vendim ka disponuar pikërisht për atë dëm ose për atë pjesë të dëmit që kërkuessa e ka kërkuar në procesin në shqyrtim si detyrim kontraktor ndaj shoqërisë së sigurimit. Së katërti, Gjykata e Lartë nuk ka treguar bazën juridike mbi të cilën ka arritur në përfundimin se njohja në favor të kërkueses e së drejtës së dëmshpërblimit drejtpërdrejt ndaj shkaktarëve të dëmit sjell edhe realizimin e së drejtës së kërkuar prej saj në këtë proces ndaj shoqërisë së sigurimit, ndonëse pranon ekzistencën e kontratës së sigurimit si burim detyrimi ndërmjet palëve. Për më tepër, nga mënyra e arsyetimit të saj duket se ajo e ka trajtuar, në thelb, detyrimin e shoqërisë së sigurimit si të pamundur për t'u kërkuar më tej prej kërkueses, pa sqaruar qartë nëse ky përfundim nënkupton shuarjen e tij ose ndonjë pasojë tjetër juridike, si dhe mbi cilën bazë ligjore mbështetet. Së fundi, Gjykata e Lartë nuk ka shpjeguar nëse dhe për çfarë arsye procesi gjyqësor civil i vënë në lëvizje nga kërkuessa kundër autorëve të veprës penale dhe personave të lidhur me ta e ka vendosur shoqërinë e sigurimit në kushtet e pamundësisë për ushtrimin e padisë së regresit ndaj shkaktarit të dëmit. Po ashtu, edhe nëse do të pranohej se ky proces ka sjellë një pasojë të tillë, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se përse kjo përbën *per se* shkak ligjor për rrëzimin e padisë së kërkueses kundër shoqërisë së sigurimit. Në këto kushte, Gjykata çmon se arsyetimi i Gjykatës së Lartë, në këtë pjesë, paraqitet i paqartë, i paplotë dhe jo mjaftueshëm i justifikuar, ndaj nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

32. Në kushtet kur, për arsytet e mësipërme, çështja duhet të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, Gjykata, në respektim të parimit të subsidiaritetit, çmon të mos ndalet në analizimin e mëtejshëm të pretendimit të kërkueses për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, **përtej** konstatimit se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë këtij pretendimi një përgjigje të shprehur dhe të arsyetuar, si dhe se arsyetimi i vendimit të saj nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Vlerësimi i mëtejshëm i këtyre pretendimeve i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë, e cila duhet të mbajë një qëndrim të shprehur dhe të arsyetuar në lidhje me to.

33. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, në lidhje me të drejtën e ankimit substancial dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4553, datë 6.11.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 5.3.2026.

Shpallur më 2.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Ilir Toska,
Marjana Semini